

Prof. Asoc. Brunilda DACI

E punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Radiometrise dhe Radiokimise, të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 32 vjeçare si punonjëse kërkimore shkencore dhe 15 vjeçare edhe si pedagoge.

Pas diplomimit në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Kimi Industriale, në vitin 1990, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me fushën e radiokimisë dhe konkretisht shënimin e përbërjeve të ndryshme me radioizotope për qëllime aplikative. Në vitin 2001 ka përfunduar shkollën pasuniversitare (SHPU) pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT dhe ka marrë gradën shkencore Doktor i Shkencave në vitin 2007.

Ka mbrojtur titullin akademik Profesor i Asociuar në vitin 2016.

Fushat ekspertizës kërkimore përfshijnë fushën e radiokimisë, matjes së rrezatimit, prodhimit dhe kontrollit të cilësisë së radiofarmaceutikateve.

Që nga viti 2008 dhe aktualisht është edhe pedagoge në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës dhe titullare e lëndës Radiokimia në Ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave në Kimi”, që nga viti 2013. Gjithashtu është angazhuar në udhëheqje diplomash të nivelit “Master” në Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ka kryer disa trajnime afatgjata e afatshkurtra dhe ka marrë pjesë në disa workshope e takime tekniko-shkencore në institucione shkencore brenda dhe jashtë vendit. Gjatë kryerjes së aktivitetit të saj shkencor ka qenë dhe është pjesë, si udhëheqëse ose pjesëmarrëse, në disa projekte shkencore, kombëtare, ndërkombëtare dhe rajonale në fushat e aplikimit të teknologjisë bërthamore në Mjeksi, Monitorimi i Ambjentit, Radiombrojtje, etj.

Ka shërbyer në disa pozicione drejtuese:

- Në vitet 2014-2016 ka drejtuar Departamentin e Radiometrisë dhe Radiokimisë, IFBZ.
- Në vitet 2018-2020 ka mbajtur postin e zëvendës drejtores së IFBZ.

Ka paraqitur aktivitetin e saj shkencor me botime në mbi 30 Konferenca Kombëtare e Ndërkombëtare dhe mbi 25 Revista Shkencore. Është bashkëautore e librit “RADIOKIMIA”.

Që nga viti 2020 dhe aktualisht është:

- Drejtore e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar,
- Anëtare e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe
- Anëtare e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulave të Universitetit të Tiranës, për tre mandate.